



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ankesa nr. 565/2023

*lidhur me cenimin e së drejtës së fëmijës për shkollim – mosangazhim të asistentit për fëmijën
me aftësi të kufizuara*

Drejtuar: Z. Ardian Gjini, kryetar
Komuna e Gjakovës

Prishtinë, më 7 prill 2025

Qëllimi i raportit

1. Ky raport ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Komunës së Gjakovës, lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut, përkatësisht cenimin e së drejtës së fëmijës për shkollim - mosangazhim të asistentit për fëmijën me aftësi të kufizuara.

Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *Kushtetuta*) përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”

Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mes të tjerash, Avokati i Popullit i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.” (Neni 16, paragrafi 4).

“Tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (Neni 18, nënparagrafi 1.2).

“Të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Neni 18, nënparagrafi 1.5).

“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Neni 18, nënparagrafi 1.6).

“Të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Pika 8).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t’i kryejë përgjegjësitë e lartcekura kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i çështjes

Faktet, dëshmitë dhe informatat që i ka Avokati i Popullit, të cilat ia ka ofruar ankuesja dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

3. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë nga [REDAKTUAR], parashtruar kundër Komunës së Gjakovës, përkatësisht kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), për shkak të cenimit të së drejtës së fëmijës së saj për shkollim parauniversitar – mosangazhim të asistentit për fëmijën e saj me aftësi të kufizuara.

4. Ankuesja pohon se djali i saj vitin e kaluar ishte përjashtuar nga shkolla “Sylejman Vokshi” në fshatin Smolicë, me arsyetimin se në këtë shkollë ka mungesë të asistentit mbështetës.
5. Ankuesja gjithashtu pohoi se në muajin tetor viti 2023 kishte parashtruar në DKA-në e Gjakovës, Kërkesë për mbështetje – caktim të asistentit për fëmijën e saj. Ajo pranoi përgjigje më 16 nëntor 2023 nga DKA-ja sipas së cilës i lejohej transferimi i fëmijës në një shkollë tjetër në Gjakovë, por pa dhënë detaje se në cilën shkollë si dhe a do t’i sigurohej transporti apo jo.
6. Përkundër faktit se ankuesja veproi në përputhje me kërkesën e DKA-së, dhe fëmijën e dërgoi në shkollën “Emin Duraku” në Gjakovë, mirëpo për shkak të numrit të madh të nxënësve, nga drejtori dhe mësuesja ju kërkua që fëmijën ta kthente sërish në shkollën “Sylejman Vokshi”.
7. Ankuesja pohoi se fëmija, edhe me ndihmën e saj, kishte ndjekur procesin mësimor në shkollën “Sylejman Vokshi”. Mirëpo, më 24 prill 2024, nga drejtori i kësaj shkolle ishte njoftuar se për mungesë asistenti, nuk kishin mundësi t’i ofronin mbështetje për mësim më shumë se dy orë.
8. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit më 3 maj 2024 ju drejtua DKA-së në Gjakovë me kërkesë për informata lidhur me rastin.
9. Avokati i Popullit më 18 qershor 2024 pranoi përgjigje nga DKA-ja në Gjakovë, me të cilën u informuar se përkundër faktit që shkolla e fshatit Smolicë nuk kishte asistent mbështetës dhe nuk kishte mundësi trajtimi adekuat, atij i ishte ofruar mësim gjithëpërfshirës nga mësimdhenësi. Gjithashtu fëmijës i ishte mundësuar transferimi në një shkollë tjetër, por nuk kishte vijuar mësimet, sepse prindërit nuk ishin pajtuar me kushtet dhe kapacitetet që u kishte ofruar shkolla.
10. Më 5 shtator 2024, ankuesja e njoftoi Avokatin e Popullit se fëmija i saj ka filluar vitin e ri shkollor, por ishte informuar se asistenti i caktuar në muajin qershor për fëmijën e saj ishte transferuar në një shkollë tjetër - pra fëmija do ta ndiqte mësimin pa asistent mbështetës.
11. Më 10 shtator 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, nëpërmjet postës elektronike kërkoi nga drejtori i DKA-së në Gjakovë informata lidhur me rastin, , mirëpo nga i njëjti nuk pranoi përgjigje.
12. Avokati i Popullit më 26 shtator 2024 ju drejtua kryetarit të komunës së Gjakovës me kërkesë për informata lidhur me veprimet që planifikoheshin të ndërmerreshin nga DKA-ja, lidhur me çështjen, mirëpo nuk pranoi përgjigje.

Instrumentet ligjore të zbatueshme

13. Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfshirë këtu të drejtat e fëmijës. Për më tepër, Kushtetuta në nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) ka paraparë: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të*

institucioneve publike.” Neni 24 i Kushtetutës përcakton: “Të gjithë janë të barabartë para ligjit.

(a) Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim,

(b) Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. [...].”

14. Ndërsa Kushtetuta në nenin 50 (Të drejtat e fëmijës) përcakton: “Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërrmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”

15. Neni 47, paragrafi 2, i Kushtetutës përcakton: “Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”

16. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) në nenin 2, paragrafi 2, përcakton: “Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit...” Kurse neni 3 përcakton: “Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”

17. Neni 28 i KDF-së përcakton: “Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta në mënyrë të veçantë ata: U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme.”

18. Këto nene të KDF-së janë themelore për garantimin e së drejtës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për shkollim dhe për sigurimin e tyre për arsim dhe trajtim të specializuar sipas nevojave të tyre të veçanta.

19. Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF), në nenin 37, paragrafi 5, nënparagrafi 5.2, përcakton: “Të mundesojnë qasjen e fëmijës, edhe arsimin parashkollor si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rast kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por që kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë.”

20. Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (LAPRK), në nenin 3, paragrafi 3, përcakton: “Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.”

21. Neni 40, paragrafi 4, i LAPRK-së përcakton “Sipas vlerësimeve individuale profesionale, komunat sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.”

22. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 17, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë: *“Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimit, pagesën e rrogave dhe trajnimit të instruktoresve dhe administratoreve të arsimit, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.”*
23. Ligji nr. 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, në nenin 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, përcakton: *“Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: “Arsim”.”*
24. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.16/2017 - Vlerësimi Pedagogjik i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, në nenin 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, përcakton: *“Komuna, vet apo në bashkëpunim me komunat brenda regjionit, duhet të themelojë ekip vlerësues pedagogjik të përhershëm.”*
25. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 19/2023 për Rolin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Asistentit për Fëmijë/Nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore, në nenin 6, paragrafi 1, përcakton: *“1. Ekipi vlerësues pedagogjik, pas vlerësimit rekomandon nëse fëmija/nxënësi ka nevojë për mbështetje nga asistenti dhe DKA nxjerr vendim. 2. Kohëzgjatja e mbështetjes nga asistenti përcaktohet pas rivlerësimit nga ekipi i vlerësimit komunal. 3. Komuna përcakton asistentin në bazë të nevojave për mbështetje të fëmijëve/nxënësve në institucione arsimore.”*

Analiza e rastit

26. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, vlerëson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit, garanton barazinë para ligjit. Në këtë drejtim, sipas këtij përcaktimi, çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë para ligjit. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut¹ dhe ky parim vlen për të gjithë, përfshirë edhe institucionet përkatëse komunale, duke qenë se shkollimi parauniversitar është pjesë e sistemit unik të edukimit dhe arsimit në Republikën e Kosovës. Për më tepër, në nenin 50 Kushtetuta ka përcaktuar se fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre dhe parimin e interesit më të mirë të fëmijës. Sipas këtij parimi, të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.
27. Parimi i interesit më të mirë të fëmijës rrjedh nga Konventa e të Drejtave të Fëmijës (KDF), si instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e të drejtave të fëmijës dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës. KDF-ja ka paraparë obligimet e shteteve që t'i ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës, e cila përbën jo vetëm njëri nga të drejtat themelore të KDF-së²,

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 21.

² KDF, neni 6.

por edhe një ndër katër parimet kryesore në interpretimin dhe zbatimin e saj.³ Ai është një koncept dinamik që kërkon një vlerësim të përshtatshëm për çdo rast specifik. Në veçanti, neni 28 i Konventës i përkushtohet së drejtës së fëmijëve për arsim dhe përfshin disa elemente kryesore: *“Arsim fillor falas dhe i detyrueshëm – Shtetet janë të detyruara të sigurojnë që fëmijët të kenë akses në arsimin fillor falas, duke e bërë atë të detyrueshëm për të gjithë, mbështetje për fëmijët në vështirësi – Konventa përfshin detyrimin për të ndihmuar fëmijët që kanë nevojë për përkrahje shtesë, duke adresuar pengesat ekonomike dhe sociale që mund të ndikojnë në arsimimin e tyre.”*

28. Lidhja e arsimit me zhvillimin shtjelohet edhe në nenin 29.1: *“Shtetet palë bien dakord që arsimimi i fëmijës të drejtohet në: (a) zhvillimin e personalitetit, talenteve dhe aftësive mendore dhe fizike të fëmijës në potencialin e tyre të plotë.”* Komenti i Përgjithshëm Nr. 1 mbi qëllimet e edukimit shpjegon se qëllimi është: *“Të fuqizojmë fëmijën duke zhvilluar aftësitë e tij, të mësuarit dhe kapacitetet e tjera, dinjitetin njerëzor, vetëvlerësimin dhe vetëbesimin.”* Kjo duhet të arrihet në mënyrë që ta vërë në qendër fëmijën, janë miqësore me fëmijën dhe pasqyrojnë të drejtat dhe dinjitetin e qenësishëm të fëmijës.⁴

29. Gjithashtu, Komiteti i KDF-së, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 9 - Të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara 9 – thekson: *“Kujdesi dhe ndihma duhet të hartohen për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje efektive dhe të përfitojnë nga arsimi, trajnimi, shërbimet e kujdesit shëndetësor, shërbimet e rimëkëmbjes, përgatitja për punësim dhe mundësi rekreacioni.”*⁵ Në veçanti, për sa i përket ndarjes së buxhetit adekuat për realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, Komiteti vlerëson se mosndarja e buxhetit të nevojshëm dhe zvogëlimi i buxhetit për realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara ka shumë implikime serioze, veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijë. Andaj shtetet palë duhet të sigurojnë që fondet e duhura të ndahen për fëmijët me aftësi të kufizuara së bashku me udhëzimet e prera për ofrimin e shërbimeve. Komiteti thekson: *“Burimet e alokuara për fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të jenë të mjaftueshme dhe të dedikuara në mënyrë që të mos përdoren për qëllime të tjera për të mbuluar të gjitha nevojat e tyre, duke përfshirë programet e krijuara për trajnimin e profesionistëve që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara si mësuesit, fizioterapistët dhe politikëbërësit; fushata edukative; mbështetje financiare për familjet; mirëmbajtja e të ardhurave; sigurimet shoqërore; pajisje ndihmëse; dhe shërbime të ngjashme.”*⁶

30. Për më tepër, Konventa kërkon nga shtetet palë që t’u japin ndihmën e duhur prindërve, kujdestarëve ligjorë dhe familjeve në përmbushjen e përgjegjësisë për rritjen e fëmijëve të tyre⁷, përfshirë ndihmën për prindërit në sigurimin e kushteve të jetesës të nevojshme për zhvillimin e fëmijës⁸ dhe sigurimin që fëmijët të marrin mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm.⁹

31. LMF-ja po ashtu ka paraparë interesin më të mirë të fëmijës, si një ndër parimet kryesore

³ Shih Komentin e Përgjithshëm Nr. 5 të Konventës të miratuar nga Komiteti i KDF-së, në: <https://www.refworld.org/docid/4538834f1.html>.

⁴ Shih Komentin e Përgjithshëm Nr. 7 të Konventës të miratuar nga Komiteti i KDF-së, në: <https://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/AdvanceVersions/GeneralComment7Rev1.pdf>

⁵ Shih Komentin e Përgjithshëm Nr. 9 të Konventës të miratuar nga Komiteti i KDF-së, në: https://www.right-to-education.org/sites/right-to-education.org/files/resource-attachments/CRC_General_Comment_9_en.pdf

⁶ Po aty.

⁷ KDF, nenet 18.2 dhe 18.3.

⁸ Po aty, neni 27.2.

⁹ Po aty, neni 3.2.

të mbrojtjes së fëmijëve. Në të njëjtën frymë me KDF-në, LMF-ja shprehimisht thotë: *“Ky Ligj, si dhe aktet e tjera juridike që rregullojnë çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të mirë të fëmijës.”*¹⁰ Gjithashtu, mosdiskriminimi përbën një ndër parimet kryesore të mishëruara në LMF, ku të gjitha institucionet, ofruesit e shërbimeve dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës duhet t’i ndërmarrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit.¹¹ Më tutje, po ky nen thekson: *“Çdo fëmijë ka të drejtë në të njëjtat të drejta të njohura me legjislacionin në fuqi dhe Konventën, t’i garantohen ato pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij, apo përfaqësuesve të tij ligjorë.”*

32. Në veçanti, kur trajton të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, LMF-ja në nenin 46, paragrafi 3, thekson: *“Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfutur nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Institucionet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.”*¹² Në po të njëjtin nen, përtej gëzimit të të drejtave, ligji parasheh obligim për autoritetet përgjegjëse që t’i eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukture, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, që fëmijët me aftësi të kufizuara t’i ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

33. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian është një instrument ligjor i BE-së, që përmbledh të drejtat themelore për qytetarët e saj dhe është e detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare. Ajo përfshin disa nene që mbrojnë të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës dhe pa diskriminim: Neni 14:

“1. Secili ka të drejtën e arsimimit dhe për të pasur mundësinë e trajnimit profesional dhe të vazhdueshëm,

2. Kjo e drejtë përfshin mundësinë për arsimim të domosdoshëm pa pagesë,

3 .E drejta për themelimin e institucioneve arsimore me respektimin e plotë të parimeve demokratike dhe e drejta e prindërve për t’u siguruar se arsimimi dhe mësimi i fëmijëve të tyre në pajtim me besimet e tyre religjioze/fetare, filozofike dhe pedagogjike duhet të respektohet në pajtim me ligjet nacionale që qeverisin ushtrimin e kësaj lirie dhe të drejte”.

Neni 21:

“1. Ndalohet çdo lloj diskriminimi që bazohet në gjini, racë, ngjyrë, origjinë etnike apo sociale, karakteristika gjenetike, gjuhë, fe apo besim, politikë ose ndonjë lloj opinioni tjetër, anëtarësi të një pakice nacionale, pronë, lindje, paaftësi, moshë ose orientim seksual,

2. Ndalohet çdo lloj diskriminimi në baza nacionaliteti, në suaza të zbatimit të Traktatit

¹⁰ LMF, neni 5 (2).

¹¹ Po aty, neni 8.

¹² LMF, neni 46.

që themelon Komunitetin Evropian të BE, dhe pa paragjykimë për dispozitat speciale të këtyre Traktateve.”

Neni 24: “(a) Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e tyre, ata mund t’i shprehin qëndrimet e tyre lirshëm. Qëndrimet e tilla do të merren parasysh për çështje që kanë të bëjnë me ata, në pajtim me moshën dhe pjekurinë e tyre, (b) Në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijë, qofshin ato të autoriteteve publike apo të institucioneve private, konsideratë primare duhet të jenë interesat e fëmijës...”.

Neni 26: “BE njeh të drejtat e personave të paaftë, në mënyrë që ata të përfitojnë nga masat e disjunara për të garantuar pavarsinë e tyre, integritimin social dhe profesional dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit ku jetojnë”¹³

34. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.16/2017 përcakton obligimin e komunës për themelimin e ekipit për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta¹⁴, e pastaj edhe detyrimin për angazhimin e asistentëve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim që të mund ta realizojnë në mënyrë të plotë të drejtën për arsimim të detyrueshëm.¹⁵ Asistentët mbështetës ndihmojnë fëmijët në aktivitete të ndryshme të përditshme në procesin arsimor duke siguruar një mjedis që përmbush nevojat e tyre individuale për të përfituar nga arsimimi.
35. Andaj, duke u bazuar në legjislacionin, në argumentet dhe në studimet e lartcekura, Avokati i Popullit vlerëson se qasja e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara, pa diskriminim, në institucionet arsimore është e drejtë elementare dhe është në interesin më të mirë të tyre.
36. Avokati i Popullit vlerëson se, në rastin konkret, e drejta e fëmijës për arsimin e obligueshëm duhet të mundësohet nga institucionet relevante, në mënyrë që fëmijëve me aftësi të kufizuara t’u mundësohet qasje sa më e lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejte.
37. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, pas rishikimit të legjislacionit përkatës të instrumenteve ndërkombëtare dhe të dokumentacionit të çështjes, konstaton se në rastin konkret ka pasur shkelje të të drejtave të fëmijëve, pasi Komuna e Gjakovës nuk i ka përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, për *trajtim të barabartë të fëmijës me aftësi të kufizuara në të drejtën e arsimit të obligueshëm*. Rrjedhimisht IAP-ja konsideron se mosaktimi i asistentit mbështetës për fëmijën e ankueses në arsimin e obligueshëm nuk është në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës.
38. Avokati i Popullit vëren se Komuna e Gjakovës aktualisht mund të mos ketë kapacitete buxhetore të mjaftueshme për angazhimin e asistentëve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit të obligueshëm, por kjo paraqet bazë të diskriminimit në të drejtën për arsimim, duke shkelur kështu të drejtën që fëmijët me

¹³ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>

¹⁴ <https://masht.rks-gov.net/ua-me-nr-16-2017-e-dt-22-12-2017-vleresimi-pedagogjik-i-femijeve-me-nevoja-te-vecanta-arsimore/>

¹⁵ Po aty, neni 4

aftësi të kufizuara, në rastin konkret fëmija i ankueses, t'i gëzojë të njëjtat të drejta si të gjithë fëmijët e tjerë.


Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla [...]”*; si dhe: *“të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.”* (Neni 18, paragrafi 1.7). Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Komunës së Gjakovës:

- T'i ndërmarrë të gjitha masat për rritjen e numrit të asistentëve mbështetës në të gjitha shkollat e komunës, ashtu që të ofroj për secilin fëmijë, pavarësisht aftësive dhe nevojave të veçanta, mundësi të barabarta për t'u arsimuar, siç garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për caktimin e asistentit mbështetës për fëmijën me nevoja të veçanta në shkollën ShFMU “Sylejman Vokshi” në fshatin Smolicë.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”*), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerri lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit